



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

INTEGRIMI I SISTEMEVE, KRIJIMI I DEPONISË SË TË DHËNAVE DHE IMPLEMENTIMI I INTELIGJENCËS SË BIZNESIT

Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji^[1] i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100²).

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit³, ekonomisë⁴, dhe efektivitetit⁵ të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Deponisë së Shënimeve dhe Implementimi i Inteligjencës biznesit” në konsultim me Ndhimës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit;
Agron Hoxha, Udhëheqëse e ekipit;
Verona Sekiraqa, Anëtar i ekipit; dhe
Gëzim Krasniqi Anëtar i ekipit;

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>

[1] Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

¹SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

²GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI

³ Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

⁴ Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

⁵ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	5
1 Hyrje	7
2 Objektivi dhe fushat e auditimit.....	9
3 Gjetjet e auditimit.....	10
3.1 Qeverisja e teknologjisë së informacionit	11
3.2 Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm	12
3.3 Politikat e kontraktimit.....	13
3.4 Kontrollat e aplikacionit.....	14
4 Konkluzionet	17
5 Rekomandimet	18
Shtojca I. Dizajni i auditimit	19
<i>Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit</i>	<i>19</i>
<i>Përshkrimi i sistemit</i>	<i>19</i>
<i>Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit.....</i>	<i>21</i>
Shtojca II: Letër Konfirmimi	24

Lista e shkurtesave

AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
CAAT	Teknikat e auditimit me ndihmën e kompjuterit (Computer assisted audit techniques)
IRK	Institucionet e Republikës së Kosovës
ISO/IEC	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim/Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (International Organization for Standardization/International Electrotechnical Commission)
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TI	Teknologjia e Informacionit
DWH	Data Warehouse-Deponia e të Dhënave
USAID	United States Agency for International Development
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KKRF	Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
DMSTI	Departamenti i Menaxhimit të Sistemeve të Teknologjisë Informative
AD	Active Directory

Përmbledhje e përgjithshme

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Komitetit Drejtues të Teknologjisë Informative dhe me mbështetjen e USAID-it në vitin 2017, ka iniciuar projektin për integrimin e sistemeve ekzistuese të teknologjisë së informacionit, të cilat janë karakterizuar nga heterogjeniteti i lartë dhe për ndërtimin e një platforme të përbashkët raportuese analitike (Business Intelligence). Si bazë për këtë sistem është paraparë krijimi i një Deponie të të Dhënave (Data Warehouse), me qëllim unifikimin e të dhënave nga Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore, Thesari, Departamenti i Buxhetit, Tatimi në Pronë, Sistemi i Burimeve Njerëzore, Sistemi i Pagave dhe institucione të tjera publike që administrojnë financa publike. Deponia e të Dhënave ka një Sistem Raportues Analitik (Business Intelligence) në dy kategori: një sistem i bazuar në veglat e Microsoft-it Power BI dhe një sistem alternativ COTS (Commercial Off-The-Shelf).

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar nëse sistemi Deponia e të Dhënave siguron të dhëna të sakta dhe të besueshme për vendimarrje makroekonomike.

Rezultatet e auditimit tregojnë se, përkundër avancimit të sistemit Deponia e të Dhënave dhe shfrytëzimit të tij nga një numër i departamenteve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ende nuk ka arritur ta shtrijë përdorimin e tij tek të gjithë zyrtarët përdorues, duke bërë që një pjesë e stafit të vazhdojë të përdorë format e vjetra të raportimit përmes e-mail-it në Excel, apo forma tjera. Po ashtu sistemi nuk njofton në mënyrë automatike nëse të dhënat janë transferuar apo jo duke detyruar zyrtarët të bëjnë verifikime manuale. Kjo gjendje rrezikon besueshmërinë e raporteve të gjeneruara nga sistemi, ul transparencën dhe e bën sistemin të varur nga individë specifik që ndikon në efikasitetin e vendimarrjes.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk posedon një strategji të miratuar për TI-në, duke vazhduar aktivitetet pa një dokument formal për analizimin dhe prioritizimin e kërkesave. Strategjia 2023–2027 e TI-së është ende draft, po ashtu edhe strategjia e mëhershme nuk ishte e aprovuar. Mungesa e formalizimit të strategjisë krijon rrezik për ndarje joefektive të resurseve dhe zhvillim të sistemeve që nuk përmbushin nevoja prioritare.

MFPT nuk i ka të dokumentuar ndërlidhjet e reja të të dhënave në sistemin Deponia e të Dhënave, duke rritur rrezikun e gabimeve dhe vështirësive në mirëmbajtje. Kjo situatë ndikon negativisht në funksionalitetin, besueshmërinë dhe transparencën e ndërlidhjeve të reja.

MFPT nuk ka siguruar funksionalitetin praktik të ditarit të aktiviteteve deri në vitin 2025 për të paraqitur në kohë reale përdoruesit dhe veprimet e tyre. Edhe pse sistemi raportues Power BI ka ruajtur log-et, raportet nuk janë kërkuar, duke bërë që MFPT të mos ketë informacion mbi përdorimin e sistemit nga zyrtarët.

Në sistemin Deponia e të Dhënave mungon një proces i automatizuar për verifikimin nëse transferimi i të dhënave nga burimet ka ndodhur me sukses. Kontrolli aktual bëhet manualisht nga zyrtarët e TI-së të cilët sigurohen që të dhënat janë transferuar me sukses, ndërsa edhe përdoruesit e sistemit raportues Power BI kontrollojnë saktësinë e raporteve. Po ashtu nuk ka procedurë për njoftimin e kodeve të reja buxhetore nga Thesari i Kosovës duke ndikuar në saktësinë e raporteve, kjo ka detyruar përdoruesit fundorë të sistemit Deponia e të Dhënave sidomos Divizionit për modelim makroekonomik të bëjnë verifikime shtesë për saktësinë e të dhënave për raportet ditore të ekzekutimit të buxhetit (tabelën 1).

Zyrtarët e Divizionit për modelim makroekonomik vazhdojnë të përdorin raporte të dyfishta, zyrtarët vazhdojnë të marrin raporte nga Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës përmes email-it ose platformave si Open Data të cilat ofrohen online nga ATK dhe Dogana. Sipas zyrtarëve të divizionit për modelim makroekonomik të dhënat në sistemin raportues Power BI kërkojnë më shumë kohë për klasifikim, ndërsa disa raporte, si ato për borxhet, mungojnë në formatin adekuat në sistem. Aktualisht, sistemi raportues Power BI nuk është i shfrytëzuar nga Departamenti i Buxhetit, ndërsa sistemi raportues COTS BI nuk përdoret nga asnjë zyrtar i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Prandaj, çështjet e identifikuara më lartë, tregojnë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, që të sigurohet funksionimi dhe përdorimi adekuat i sistemit të deponisë së të dhënave dhe proces efikas i raportimit në funksion të vendimmarrjes. Lidhur me të gjeturat më lartë, kemi dhënë gjithsej gjashtë (6) rekomandime, për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Lista e rekomandimeve, është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e entitetit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka përgjegjësi të gjera në fushat e financave publike, politikave ekonomike, punësimit dhe mirëqenies sociale. E themeluar për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin fiskal të vendit, MFPT luan një rol thelbësor në hartimin dhe zbatimin e politikave fiskale dhe ekonomike. Struktura e saj organizative përfshin një sërë departamentesh si: Departamenti i Buxhetit, i cili merret me planifikimin, përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit të shtetit; Departamenti i Thesarit, që menaxhon ekzekutimin e buxhetit dhe transaksionet financiare të qeverisë; Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Financiare, i cili analizon dhe zhvillon politika për stabilitetin ekonomik; Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale, që fokusohet në zhvillimin e politikave të punësimit dhe mirëqenies sociale; si dhe Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme, që ofron mbështetje logjistike dhe administrative për funksionimin e ministrisë.

Përveç departamenteve të cekura më lartë, MFPT mbikëqyr agjencitë të rëndësishme siç janë: Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), e cila është përgjegjëse për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe zbatimin e politikave tatimore, Doganën e Kosovës, e cila menaxhon dhe kontrollon importin, eksportin dhe mbledhjen e të ardhurave doganore, si dhe Agjencinë e Punësimit dhe Aftësimin Profesional, e cila mbështet zhvillimin e tregut të punës përmes programeve të trajnimit profesional. MFPT bashkëpunon ngushtë me institucione ndërkombëtare dhe vendore për të siguruar që politikatat e saj financiare dhe sociale të jenë në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare, duke vënë theks të veçantë në transparencën fiskale, efikasitetin e shpenzimeve publike dhe ndërtimin e një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik dhe social në Kosovë.

MFPT ka ndërmarrë hapa konkret për të përmirësuar infrastrukturën e saj teknologjike dhe për të rritur efikasitetin institucional. Në këtë drejtim, me mbështetjen e USAID-it ka synuar të unifikojë sistemet e TI-së të institucioneve publike (si Doganat, ATK, Thesari, etj.) përmes krijimit të një Deponia e të Dhënave dhe implementimit të një sistemi analitik të raportimit (Business Intelligence). Qëllimi i implementimit të këtij sistemi është rritja e transparencës, marrja e vendimeve makroekonomike dhe monitorimi në kohë reale të financave publike.

Projekti përfshinë: Integrimin e të dhënave përmes proceseve ETL (Extract, Transform, Load), ruajtjen e të dhënave për të paktën 10 vjet me integritet të plotë. Për këtë projekt kërkohet të implementohet sistemi raportues analitik-Business Intelligence, i cili duhet të jetë në dy kategori:


- Sistemi Raportues Analitik, përmes veglave të punës së Microsoft, gjegjësisht Microsoft Power View, Report Designer dhe Report Builder, ose ekuivalente të cilat duhet të jenë të qasshme përmes shfletuesve të internetit (Safari, Internet Explorer Mobile, Internet Explorer 10 dhe Firefox).
- Sistemi Raportues Analitik, COTS (Commercial of the Shelf) - i implementuar në të paktën nga tre organizata tjera, të përafërta me Ministrinë e Financave, për të shmangur varësinë nga licencat, krijimin e raporteve statike dhe dinamike, dashboards, qasje mobile dhe jashtë domain-it të ministrisë, lidhje me sisteme të jashtme dhe ndërtim të planit kombëtar të veprimtimit në bazë të të dhënave.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve aktualisht posedon këto sisteme, nga të cilat do të popullohet Deponia e të Dhënave:

Procedura e nxjerrjes, transformimit dhe mbushjes së Deponisë së të Dhënave
Kërkohet që të dhënat të procedohen përmes procedurave ETL (Extract, Transform and Load), pastaj të barten në Deponia e të Dhënave, si dhe të krijohen Deponitë e Specializuara, të njohura si *Data Marts*. sistemi duhet të japë zgjidhjen për mënyrën e konsumit të të dhënave në kohë reale nga sistemet tjera, t'i shfaqë ato në veglën për ilustrim dhe t'i ruajë ato rezultate në sistemin Deponia e të Dhënave.

Sistemet që janë integruar në këtë projekt janë të paraqitura në grafikën më poshtë:

Grafiku 1. Paraqitja skematike Sistemit të integruar:



2 Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektiv i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka arritur në mënyrë efektive të zbatoj projektin “Integrimi i sistemeve, krijimi i deponisë së të dhënave dhe implementimi i Inteligjencës së Biznesit” dhe sa ka arritur të siguroj të dhëna transparente, me integritet dhe në kohë reale.

Përmes këtij auditimi synohet të ofrohen rekomandime për MFPT-në, me qëllim që të përmirësohet menaxhimi dhe zbatimi i projekteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), për të siguruar përdorim më efikas të burimeve dhe rezultate të qëndrueshme në sistemet e zhvilluara.

Për t’u përgjigjur objektivit të auditimit jemi fokusuar në fushat: Qeverisja e TI-së, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm, Politikat e kontraktimit dhe Kontrollat e aplikacionit.

Tabela 1: Fushat dhe çështjet e auditimit

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Qeverisja e TI-së:	1. Identifikimi, Drejtimi dhe Monitorimi i kërkesave të biznesit;
2. Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm	2. Menaxhimi dhe Kontrolli i projektit;
3. Politikat e kontraktimit	3. Marrëveshja në Nivel Shërbimi (SLA);
4. Kontrollet e aplikacionit	4. Kontrollet e përpunimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative, në kuadër të të cilit funksionojnë këto divizione: Divizioni për Infrastrukturë dhe Sigurinë e TI-së, Divizioni për Operacione të TI-së dhe Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve. Pjesë e fushëveprimit do të jetë Divizioni për Modelim Makroekonomik, Këshilli Kosovar për Raportime Financiare(KKRF), Divizioni për Ekzekutim të Buxhetit dhe Raportim.

Auditimi do të mbulojë periudhën viti 2023 deri në qershor 2025, me qëllim analizimin e implementimit dhe efektit të projektit “Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Deponisë së Dhënave dhe Implementimi i Inteligjencës së Biznesit”. Ndërsa, për të vlerësuar arsyeshmërinë e inicimit të një projekti të tillë dhe zbatimit, do të analizohet edhe periudha nga viti 2016.

3 Gjetjet e auditimit

Qëllimi i sistemit Deponia e të Dhënave (tutje DWH) është të unifikojë burimet kryesore të të dhënave – si ATK, Dogana, Thesari, Buxheti, Tatimi në Pronë – për të ofruar informacione të përditësuara mbi të hyrat, shpenzimet dhe buxhetin në nivel vendi. Me kalimin e viteve, sistemi është zgjeruar duke përfshirë edhe pasqyrat financiare për Këshillin Kosovar për Raportime Financiare (KKRF) si dhe të dhënat për të gjitha skemat pensionale dhe sociale në Kosovë. Përveç kërkesës për popullimin e sistemit DWH me të dhëna nga institucione tjera ky sistem përballet edhe me sfida të përdorimit të tij nga zyrtarët brenda MFPT-së.

Gjetjet e auditimit ndërlidhen Qeverisjen e TI-së, Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm, Politikat e kontraktimit si dhe Kontrollat e aplikacionit bazuar në testet kufizuara të kontrolleve për këtë sistem. Gjetjet janë të strukturuar sipas fushave dhe çështjeve të auditimit.




Figura 1. Struktura e çështjeve të auditimit në sistemin DWH

Pjesa e parë e paraqitur në kapitullin 3.1 mbulon çështjet e identifikuar që kanë nevojë për përmirësim që lidhen me Qeverisjen e TI-së të sistemeve të informacionit (1-2).

Pjesa e dytë që është paraqitur në kapitullin 3.2 mbulon çështjet e identifikuar që lidhen me zhvillimin dhe blerjen (3).

Pjesa e tretë që është paraqitur në kapitullin 3.3 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen politikat e kontraktimit (4).

Pjesa e katër që është paraqitur në kapitullin 3.4 mbulon çështjet e identifikuara që lidhen me kontrollet e aplikacionit (5-6).

3.1 Qeverisja e teknologjisë së informacionit

Qeverisja e TI-së përkufizohet si strukturë e përgjithshme që udhëheq operacionet e TI-së të një institucioni dhe siguron që sistemet e TI-së mbështesin dhe mundësojnë arritjen e objektivave të institucionit, si dhe luan një rol kyç në përcaktimin e një mjedisi kontrollues dhe raportues. Elementet kyçe të qeverisjes së TI-së janë: strategjia dhe planifikimi i TI-së; strukturat, standardet, politikat dhe procedurat, zhvillimi dhe blerja, burimet njerëzore, etj.⁶

Çdo organizatë duhet të angazhohet në identifikimin e nevojave të reja ose të përditësuara dhe më pas në ofrimin e zgjidhjeve të duhura TI-së për përdoruesit e biznesit. Gjatë zhvillimit ose blerjes së zgjidhjeve të nevojave të biznesit, Qeverisja e TI-së siguron që zgjedhjet e bëra janë të duhurat për biznesin dhe se trajnimi dhe burimet e nevojshme (harduer, vegla, kapaciteti i rrjetit etj.) janë të disponueshme për implementimin e zgjidhjeve.

1. MFPT vazhdimisht zhvillojnë aktivitetet pa strategji të TI-së të aprovuar

MFPT duhet të ketë një plan në nivel strategjik i TI-së, i cili përkthen objektivat e biznesit në qëllime dhe kërkesa të TI-së, adreson burimet e nevojshme për të mbështetur biznesin. Paralelisht me procesin e hartimit të dokumentit strategjik duhet hartuar edhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj. Ai duhet të monitorohet, rishikohet dhe azhurnohet sistematikisht.

MFPT nuk posedon strategji të formalizuara për identifikimin, analizën dhe prioritizimin e kërkesave për sistemet e TI-së. Strategjia për TI-në e përgatitur për vitet 2023-2027 e hartuar me mbështetjen e GIZ-it, është dërguar në Këshillin Drejtues për Teknologji të Informacionit nga komiteti teknik por ende ka mbetur e pa aprovuar nga Komiteti Drejtues. Andaj, MFPT nuk ka ndonjë dokument në fushën e TI-së të miratuar me të cilin ka planifikuar nevojat e saj afatgjate për zhvillimin e projekteve në fushën e TI-së. Sipas MFPT-së nevojat e saj të planifikuara i ka të përfshira në “Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës 2022-2026”. Në planin e veprimit ka të përfshira aktivitetet e saj lidhur me zhvillimin e projekteve të TI-së.

Për identifikimin dhe prioritizimin e kërkesave për sistemet e teknologjisë së informacionit MFPT është bazuar në dy dokumente të hartuara në vitin 2013 me mbështetje të USAID-it. Në njërën nga këto dokumente përfshihet “Plani Strategjik i Punës”, i cili ka synuar zbatimin e tij përmes shtatë shtyllave strategjike. Një nga shtyllat kryesore fokusohet në analitikën e të dhënave duke përfshirë integrimin e sistemeve, krijimin e deponisë së të dhënave dhe zbatimin e inteligjencës së biznesit.

Sipas MFPT-së edhe pse Plani strategjik i punës nuk është aprovuar formalisht me vendim të Komitetit Drejtues të TI-së, ato janë konsideruar si plane strategjike pune dhe si të tilla nuk kanë kërkuar aprovim të detyrueshëm formal në atë kohë.

⁶ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit, Qeverisja e TI-së.

Mungesa e një mekanizmi legjitim për analizimin dhe prioritizimin e kërkesave për TI-në paraqet rrezik që burimet e kufizuara financiare dhe teknike të mos alokohen në mënyrën më të efektshme, duke zhvilluar sisteme që nuk kanë domosdoshmëri të menjëhershme apo që nuk kanë ndikim të lartë në përmirësimin e shërbimeve. Po ashtu, pa një proces të qartë dhe transparent, mund të shfaqet vendimmarrje subjektive, ndërsa kërkesat e departamenteve mund të trajtohen në mënyrë të pabarabartë. Kjo ndikon negativisht në efikasitetin organizativ dhe harmonizimin ndërinstytucional të investimeve në TI-së.

2. Mungesë e dokumentuar e trajnimeve për përdoruesit e sistemit raportues Power BI

Organizatat duhet të monitorojnë dhe rishikojnë në mënyrë të rregullt aftësitë dhe kompetencat e stafit për të siguruar që ato janë të përditësuara dhe në përputhje me kërkesat e roleve dhe objektivave të biznesit. Kjo përfshin kryerjen e vlerësimeve periodike të njohurive, mbajtjen e regjistrave të përditësuar për aftësitë ekzistuese, përdorimin e matjeve për të vlerësuar efektivitetin e trajnimeve dhe përfshirjen e këtyre analizave në ciklin e vlerësimit të performancës, me qëllim identifikimin dhe mbulimin e boshllëqeve përmes ndërhyrjeve si trajnimet, mentorimi ose certifikimet.⁷

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk posedon një bazë të plotë dhe të standardizuar të të dhënave lidhur me trajnimet për përdorimin e sistemit raportues Power BI. Edhe pse Divizioni i Zhvillimit të Aplikacioneve ka ofruar disa dëshmi (e-mail) për realizimin e trajnimeve, mungon një qasje e strukturuar dhe e dokumentuar që adreson nevojat për zhvillim profesional të stafit.

Mungesa e evidencës zyrtare dhe lëvizja/largimet e stafit, veçanërisht në Departamentin për Modelim Makroekonomik, e bëjnë të pamundur verifikimin e aftësive aktuale të përdoruesve dhe identifikimin e nevojave për trajnim të mëtejshëm, duke rrezikuar cilësinë dhe vazhdimësinë e analizave në këtë sistem.

3.2 Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm

Me qëllim që të mbështetet strategjia e biznesit, sektorët e TI-së ofrojnë zgjidhje ndaj biznesit dhe përdoruesve të tij. Procesi i zhvillimit, blerjes, ose kontraktimit për një zgjidhje duhet të planifikohet në mënyrë që rreziqet të menaxhohen dhe të maksimizohen mundësitë për sukses. Përveç kësaj, kërkesat për këto zgjidhje duhet të identifikohen, analizohen, dokumentohen dhe prioritizohen. Organizatat mund të kontraktojnë gjithashtu siguri të cilësisë dhe funksione testimi, për të garantuar cilësi të këtyre zgjidhjeve.⁸

3. Mungesa e një procesi të dokumentuar për testimin dhe pranimin e të dhënave të reja

Organizata duhet të kryej testimet mbi sistemet e TI-së dhe duhet të bazohet mbi rezultatet për pranimin ose refuzimin e sistemit. Organizata duhet të ketë një proces të formalizuar dhe të dokumentuar për testimin e sistemeve të TI-së. Ky proces duhet të përfshijë planifikimin, kryerjen e testimeve teknike dhe funksionale, dokumentimin e rezultateve dhe bazimin e vendimit për pranimin ose refuzimin e sistemit në rezultatet konkrete të testimit.⁹

⁷ COBIT 2019 në nën-praktikën APO07.03.06

⁸ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit

⁹ ISO/IEC 12207,

Nga analiza e dokumentacionit për sistemin Deponia e të Dhënave, është konstatuar se Ministria gjatë instalimit dhe ndërlidhjes fillestare ka të testuar dhe dokumentuar të gjitha modulet ndërsa viteve të fundit është paraqitur nevoja për ndërlidhjen me të dhëna/sete¹⁰ të të reja ku MFPT ka ndërlidhur edhe të dhënat për të gjitha pasqyrat financiare, gjithsej 10 sete/të dhëna, për skemat pensionale dhe skemat sociale, gjithsej 36 skema, të dhënat nga thesari 5 shifrorë, të dhënat e Payrollit/pagave nga ATK për të gjithë të punësuarit. Por për këto të dhëna/sete nuk e ka të dokumentuar mënyrën e ndërlidhjes dhe testimin e tyre. Sipas zyrtarëve arsyeja e mos dokumentimit të dhënave/seteve të reja është mungesa e stafit duke marrë parasysh se ky divizion menaxhon me rreth 13 sisteme. Mungesa e dokumentimit të ndërlidhjeve të të dhënave/seteve të reja rrezikon humbjen e njohurive teknike në rast ndryshimi të stafit, vështirëson mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit, dhe krijon paqartësi për përdoruesit fundorë sa i përket burimit të dhënave të paraqitura në sistemin raportues Power BI.

Përveç kësaj divizioni i aplikacioneve nuk posedon një procedurë të shkruar për testimin dhe pranimin e të dhënave/seteve të reja në sistemin Power BI. Zyrtarët kanë deklaruar se në praktikë procesi i testimit bëhet duke përfshirë zyrtarët kompetent nga entiteti të cilët marrin të dhënat dhe nga zyrtarët që përdorin sistemin dhe më pas krahasojnë nëse sistemi funksionon siç pritet. Megjithatë, ky proces është joformal dhe nuk dokumentohet në mënyrë sistematike, nuk ekziston procedurë e qartë për planifikim të testimeve, rezultate të testimeve, identifikim dhe trajtim të gabimeve apo mbajtja e një vendimi të protokolluar për pranimin apo refuzimin e të dhënave/seteve të reja.

Mungesa e një procedure të shkruar dhe e dokumentacionit përkatës paraqet rrezik që të dhënat/setet të vendosen në përdorim pa u testuar në mënyrë të mjaftueshme, gjë që mund të sjellë probleme funksionale, gabime në përpunimin e të dhënave apo ndërprerje të shërbimeve. Gjithashtu, vendimet për pranimin e të dhënave/seteve mund të merren në mënyrë subjektive, pa pasur bazë objektive të dokumentuar.

3.3 Politikat e kontraktimit

Organizatrat duhet të kenë disa politika të cilat përcaktojnë se cilat funksione mund të kontraktohen dhe cilat funksione duhet të zhvillohen në ambientet e organizatës. Një politikë e kontraktimit siguron që propozimet për operacionet e jashtme dhe/ose funksionet, bazën e të dhënave do të zhvillohen dhe zbatohen në një mënyrë të dobishme për organizatën.

4. Mungesa e aktivizimit të ditarit të aktiviteteve për sistemin e deponisë së të dhënave

Ekipi menaxhues duhet të sigurojë që OE përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dorëzimit, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, si dhe të sigurojë që OE dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me këto terma dhe kushte.¹¹ Në sistem duhet të ekzistojnë gjurmë të mjaftueshme auditimit¹².

¹⁰ Setet janë grupime të organizuara të të dhënave të përgatitura për analizë dhe raportim.

¹¹ Vendim mbi caktimin e ekipit menaxhues të Kontratës nr. 92/2018

¹² Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrolllet e Sigurisë së Aplikacionit

Implementimi i kërkesave të kontratës nga ana e operatorit ekonomik është monitoruar nga Ekipi Menaxhues, në përbërje të të cilit kanë qenë dy anëtarë nga MFPT dhe një nga ATK.

Lidhur me pranimin e implementimit të aplikacioneve të sistemit Deponia e të Dhënave, Power BI dhe COTS, MFPT ka angazhuar një ekspert nga GIZ për të përkrahur/ndihmuar komisionin në lidhje me implementimin e këtyre aplikacioneve në sistem.

Angazhimi i këtij eksperti, është bërë me qëllim të shfrytëzimit të njohurive të tij në fushën e sistemeve integruese për deponinë e të dhënave, e cila fushë ka qenë të panjohura më parë për Ministrinë.

Një nga kërkesat e kontratës për sistemin Deponia e të Dhënave ka qenë implementimi i ditarit të punës, i cili në kohë reale duhet të paraqesë përdoruesit aktualë dhe veprimet e kryera, duke përfshirë adresën IP, kohën dhe ngjarjen e ndodhur. Ky komponent duhet të kishte të zhvilluar edhe faqen ndërvepruese (interface).

Komisioni i menaxhimit të kontratës ka bërë pranimin e implementimit të Deponisë së shënimeve nga kontraktuesi. Megjithatë, ndonëse sistemi Power BI i ka ruajtur aktivitetet e përdoruesve (logs), deri në kohën e auditimit nuk është kërkuar nga personat përgjegjës një raport i tillë dhe si pasojë e kësaj MFPT nuk ka pasur informacion të cilët zyrtarë përdorin sistemin dhe mënyrën e përdorimit.

3.4 Kontrollat e aplikacionit

Kontrollet e aplikacioneve janë kontrolle për të siguruar dhe mbrojtur saktësinë, integritetin, realizueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit. Këto sigurojnë inicimin e transaksioneve të autorizuar në mënyrën e duhur, procesimin e të dhënave të vlefshme, regjistrimin e plotë dhe raportimin e saktë.

5. Mungesa e automatizimit dhe evidencës në kontrollin e transferimit të të dhënave

Aplikacioni identifikon në mënyrë korrekte gabimet në transaksione. Integriteti i të dhënave ruhet edhe gjatë ndërprerjeve të rastësishme në përpunimin e transaksioneve. Ekziston një mekanizëm i përshtatshëm për trajtimin e gabimeve në përpunim, rishikim dhe qartësim të dosjeve në pezullim.¹³

Nga dëshmitë e ofruara, konstatojmë se sistemi identifikon nëse të dhënat të cilat janë transferuar nga burimi i sistemit Deponia e të Dhënave janë të dubluara (dyfishuara), mirëpo sistemi nuk njofton në mënyrë automatike (e-mail) për të identifikuar nëse ka ndodhur apo nuk ka ndodhur transferimi i të dhënave/seteve, si dhe gjatë procesit të transferimit të të dhënave nga burimi në sistemin Deponia e të Dhënave nëse ka pasur ndonjë problem apo ndërprerje. Kjo detyrë mbetet të kryhet nga zyrtarët e TI-së, të cilët megjithëse deklarojnë se e realizojnë këtë kontroll në baza ditore, nuk mbajnë evidencë dhe nuk raportojnë për këtë kontroll.

Përveç TI-së, një kontroll shtesë bëhet edhe nga përdoruesit e sistemit Power BI, të cilët kryesisht janë stafi i Divizionit për Modelim Makroekonomik të cilët pranojnë të dhënat e njëjta përmes email-it dhe të cilët për t'u siguruar se të dhënat në sistem për tabelën 1 janë të sakta atëherë janë të detyruar t'i bëjnë krahasimin e raportit të cilin pranojnë në e-mail në baza ditore me të dhënat në sistemin Power BI, edhe pse nga Divizioni për Modelim Makroekonomik cekin se për shkak të

¹³ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit – Kontrollat e Aplikacioneve

lëvizjes së lartë të stafit këtë krahasim e bëjnë në baza javore. Por në rast se as nga ana e TI-së dhe as nga përdoruesit finalë nuk kryhet ky krahasim, atëherë të dhënat që prezantohen në sistem për tabelën 1 Power BI mund të jenë jo të plota dhe të pasakta.

Si pasojë, vendimmarrja e bazuar në këto të dhëna mund të jetë e pasigurt dhe të çojë në vendime të gabuara, që rrezikojnë cilësinë dhe drejtësinë e proceseve menaxheriale dhe strategjike.

Në anën tjetër, kemi raste kur Thesari gjeneron kod të ri buxhetor për shpenzime pesë shifror apo përdor kode buxhetore i cili nuk është i përfshirë në tabelën një (tabela 1)¹⁴ të cilat nuk i kanë përdorur deri në kohë të caktuar. Kjo informatë nuk përcillet nga Thesari tek divizioni për aplikacione të cilët duhet të ndërhyjnë në kode për të modifikuar dhe si pasojë raporti i cili gjenerohet nga sistemi Deponia e të Dhënave nuk është i saktë. Zyrtarët e thesarit deklarojnë se nuk e kanë obligim apo procedurë për njoftim të ndryshimit/shtimit të kodeve të reja buxhetore. Në mungesë të këtij koordinimit formal në mes të thesarit dhe divizionit të aplikacioneve, zyrtarët e këtij divizioni janë të detyruar të kontaktojnë zyrtarët përgjegjës në thesar për t'u njoftuar lidhur me ndryshimet në kodet e reja.

6. Zyrtarët e Departamentit të Divizionit për Modelim Makroekonomik vazhdojnë të përdorin raporte të dyfishta

Më qellim të unifikimit të sistemeve softuerike të MFPT-së, të Doganës së Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës, dhe të institucioneve tjera MFPT ka zhvilluar deponinë e të dhënave dhe ka implementuar një makinë për analizë biznesi apo inteligjencë biznesi (ang. Business Intelligence) në mënyrë që të posedoj informacione në kohë reale për statusin dhe zbatimin e politikave qeveritare në njërën anë, avancimin e politikave qeveritare dhe rritjen e transparencës në anën tjetër.¹⁵

Zyrtarët e MFPT, si shfrytëzuesit kryesorë të Sistemit Deponia e të Dhënave, përveç raporteve të gjeneruara nga sistemi Power BI ende vazhdojnë të përdorin raporte nga Open Data që gjenerohen nga agjencionet si ATK dhe Dogana. Për ilustrim, kemi rastin e Doganës, kur zëra/kategori të të dhënave që janë futur në raportet e Doganës, por që nuk janë sinkronizuar edhe në Sistemin Deponia e të Dhënave. Ky mos sinkronizim vjen si pasojë e mos inicimit të një takimi formal në mes të Divizionit për Modelim Makroekonomik dhe Doganës që këto ndryshime të përcillen te zyrtarët e TI-së të departamenteve në fjalë, e pastaj këta të fundit të bëjnë pjesën teknike- sinkronizimin e të dhënave.

Sipas MFPT-së arsye tjetër se pse përdorën raporte të dyfishta, sipas zyrtarëve, është se ka disa raporte që i pranojnë nga agjencionet (që janë të gjeneruara nga Open Data), janë më praktike për përdorim sesa ato që gjenerohen nga Power BI.

Pamundësia e Sistemit për të identifikuar në mënyrë automatike problemet në transferim të të dhënave krijon nevojën për angazhimin e zyrtarëve të TI-së që të bëjnë këtë kontroll.

Mungesa e raportimit nga ana e zyrtarëve për verifikimin e transferimit të të dhënave bën që divizioni për modelim makroekonomik të mos kenë siguri për saktësinë e raportit (tabela 1). Si rezultat, ata detyrohen të kryejnë vetë një kontroll shtesë për të siguruar vërtetësinë e tyre.

¹⁴ Tabela 1 Raporti i ditor i ekzekutimit të buxhetit për vitin e caktuar

¹⁵ Dosja e tenderit për kontratën publike kornizë – shërbim me një operator ekonomik

Aktualisht, një numër departamentesh në kuadër të MFPT-së përdorin aktivisht sistemin Deponia e të Dhënave përkatësisht sistemin Power BI për raportim dhe analizë të të dhënave ndërsa sistemi Cost Business Intelligence (COST BI) nuk përdoret nga zyrtarët e MFPT-së. Sistemi Power BI përdoret nga: Ministri, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Departamenti i Politikave Ekonomike, Departamentin për Raportim Financiar, Departamentin e Financimit, Departamentin e Tatimit në Pronë, Divizionin për Transparencë dhe Departamentin për Buxhet dhe Financa. Ndërkohë, Departamenti i Buxhetit, megjithëse ka qasje të plotë në sistem dhe posedon të dhënat përkatëse, nuk e përdor sistemin.

Nga diskutimet të cilat kemi zhvilluar me zyrtarët e MFPT-së edhe pse sistemin e shfrytëzojnë në baza ditore ata pranojnë edhe raporte në e-mail nga Dogana të cilat janë të përfshira edhe në Open Data (sistemi i Doganës) dhe në sistemin Power BI por sipas zyrtarëve marrja e të dhënave përmes sistemit Power BI merr kohë më të madhe sepse nevojitet proces i klasifikimit/selektimit të të dhënave. Po ashtu, ATK deponon të dhëna në sistemin Open Data dhe në sistemin Power BI, dhe dërgon raporte përmes e-mail-it në formën Excel. Megjithatë, sa i përket të dhënave për borxhet, ato nuk janë të vendosura në sistemin Power BI sipas formatit të përcaktuar. Në vend se të shfrytëzojnë të dhënat nga sistemi Deponia e të Dhënave, zyrtarët përkatës përdorin të dhëna nga platforma të tjera si: Open Data e Doganës, Open Data e ATK-së, apo të dhënat e pranuar përmes e-mail-it në formë Excel-i.

4 Konkluzionet

MFPT ka bërë hapa në zhvillimin e sistemeve të TI-së për përmirësimin e raportimit dhe menaxhimit të të dhënave. Sistemi për integrimin e të dhënave Deponia e të Dhenave ka mundësuar grumbullimin e të dhënave nga sistemet e MFPT-së, ATK-së, Doganës, Buxhetit, Tatimit në Pronë duke grumbulluar informata në baza ditore, javore dhe mujore për të hyrat, shpenzimet dhe buxhetin në nivel vendi. Megjithatë, mungesa e proceseve të formalizuara, dokumentimit të plotë të proceseve dhe koordinimit të brendshëm ka rezultuar në dobësi në, testimin e të dhënave/seteve dhe integritetin e dhënave për raportet ditore të ekzekutimit të buxhetit (tabelës 1). Kjo ka ndikuar në përdorimin e mangët të sistemit për raportet ditore të buxhetit, shfrytëzim të raporteve të dyfishta, duke rrezikuar efikasitetin dhe besueshmërinë e raporteve.

Qeverisja e TI-së

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk ka formalizuar strategjinë për menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit, duke vepruar pa një strategji të miratuar për TI-në dhe pa mekanizma për analizimin dhe priorizimin e kërkesave për sisteme të reja. Kjo mungesë planifikimi sjell rreziqe për alokim joefektiv të burimeve dhe zhvillim të zgjidhjeve që nuk adresojnë nevojat prioritare. Për më tepër, mungon dokumentimi i trajnimeve për përdorimin e sistemit Power BI i cili e bën të pamundur vlerësimin e aftësive aktuale të stafit dhe krijon pasiguri në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e analizave.

Zhvillimi, Blerja dhe Kontraktimi i jashtëm

MFPT nuk ka dokumentuar mënyrën si janë ndërlidhur të dhënat/setet reja Deponia e të Dhenave. Gjithashtu, mungon një procedurë e shkruar për testimin dhe pranimin e të dhënave/seteve të reja. Testimet kryhen në mënyrë joformale dhe pa evidencë, duke rrezikuar gabime në funksionim dhe mungesë transparence.

Politikat e kontraktimit

MFPT nuk ka siguruar përdorimin praktik të ditarit të punës në kohë reale dhe interface-it për gjurmimin e përdoruesve. Mungesa e kërkesës për raporte nga log-et ka rezultuar që MFPT të mos ketë informacionin e përdoruesve aktivë të sistemit.

Kontrollet e aplikacionit

Mungesa e një procesi të automatizuar për verifikimin e transferimit të të dhënave në sistemin Deponia e të Dhenave, si dhe mungesa e dokumentimit të kontrolleve manuale nga TI-së, rrit rrezikun për pasaktësi dhe mungesë të besueshmërisë së të dhënave. Përdoruesit detyrohen të krahasojnë të dhënat përmes raporteve të dërguara me e-mail. Po ashtu, mungesa e koordinimit dhe komunikimit formal për ndryshimet në kodet buxhetore çon në pasaktësi të raporteve.

5 Rekomandimet

Rekomandojmë Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve:

1. **Plani Strategjik i TI-së**, MFPT duhet të sigurojë miratimin formal të Planit Strategjik të TI-së dhe të krijojë një mekanizëm të qartë dhe të miratuar për identifikimin dhe prioritizimin e kërkesave për TI-në, me qëllim përdorimin efektiv të burimeve dhe harmonizimin e investimeve ndërinstitucionale.
2. **Plani i trajnimeve**, të zhvillojë dhe zbatojë një mekanizëm të qartë dhe të standardizuar për planifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e trajnimeve të stafit për përdorimin e sistemeve të TI-së përkatësisht sistemit Power BI.
3. **Pranimi dhe testimi i të dhënave të reja**, MFPT duhet të hartojë dhe zbatojë një procedurë të formalizuar dhe të dokumentuar për testimin dhe pranimin e të dhënave të reja. Kjo duhet të përfshijë planifikimin e testimeve, dokumentimin e rezultateve dhe marrjen e vendimeve për pranim/refuzim e të dhënave/seteve bazuar në rezultatet e testimit, për të siguruar funksionalitet, saktësi dhe qëndrueshmëri të sistemeve.
4. **Menaxhim i kontratës dhe zbatimi i kërkesave të sigurisë**, MFPT duhet të ketë të aktivizuar në vazhdimësi ditarin e aktiviteteve të përdoruesve dhe të sigurojë shqyrtimin periodik të tij, në mënyrë që të mundësohet gjurmimi i plotë i përdorimit të sistemit nga përdoruesit.
5. **Automatizimi dhe dokumentimi i kontrollit në transferim të dhënave**, MFPT duhet të automatizojë dhe dokumentojë procesin e kontrollit të transferimit të të dhënave, duke siguruar evidencë dhe raportim të rregullt. Të zhvillohet një procedurë formale e komunikimit ndërmjet agjencive burimore dhe Divizionit për modelim makroekonomik, me qëllim që çdo ndryshim në strukturën apo përmbajtjen e të dhënave të përcillet në kohë dhe të përfshihet në raportet e Sistemit Deponia e të Dhënave.
6. **Koordinimi dhe sinkronizimi i sistemeve**, MFPT duhet të përmirësojë koordinimin dhe sinkronizimin e të dhënave midis sistemeve Deponia e të Dhënave dhe subjekteve burimore të të dhënave, si dhe të promovojë e siguroj përdorimin të raporteve nga Power BI për të eliminuar përdorimin e raporteve të dyfishta dhe për të rritur efikasitetin.

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe treguesit e problemit të auditimit

Integrimi i sistemeve, krijimi i Deponisë së të Dhënave (Data Warehouse) dhe implementimi i Inteligjencës së Biznesit (Business Intelligence) në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përbën një nga projektet më ambicioze dhe me rëndësi strategjike për modernizimin e infrastrukturës digjitale të financave publike në Kosovë. I mbështetur nga USAID dhe me një kosto rreth 2.5 milionë euro, ky projekt përmes unifikimit të të dhënave nga institucionet kyçe si Dogana, ATK, Thesari dhe të tjera është zhvilluar me synim për rritjen e transparencës, përmirësimin e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna dhe sigurimin e monitorimit në kohë reale të financave publike.

Megjithatë, pavarësisht objektivave të synuara, ky projekt paraqet disa mangësi nga këndvështrimi i auditimit. Duke ju referuar raportit të auditimit të vitit 2020 rreth investimeve në fushën e TI-së nga institucione publike¹⁶ dhe gjatë fazës parastudimore, pas shqyrtimit të dokumenteve që lidhen me këtë sistem si dhe pas zhvillimit të intervistës me zyrtarët përgjegjës për sistemin, kemi indikacione se:

- MFPT nuk ka bërë analizë të mirëfilltë të fizibilitetit për zhvillimin e sistemeve të informacionit e cila do t'i ndihmonte në identifikimin dhe specifikimin e kërkesave të nevojshme të institucionit;
- shkalla e përdorimit efektiv të këtij sistemi nga zyrtarët përgjegjës në ministri dhe agjencitë e ministrisë nuk është e plotë;
- ky projekt nuk është zhvilluar plotësisht në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Këto çështje janë thelbësore për të vlerësuar arsyeshmërinë e investimit të bërë, efikasitetin operacional të sistemit dhe ndikimin e tij në proceset vendimmarrëse dhe në rritjen e llogaridhënies brenda sistemit të financave publike.

Përshkrimi i sistemit

Sistemi për krijimin e deponisë së shënimeve dhe zbatimi i inteligjencës së biznesit është implementuar nga Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë me qëllim të planifikoj, zhvilloj, administroj, monitoroj, mirëmbaj dhe zbatoj shërbimet efikase dhe efektive të teknologjisë informative për Ministrinë, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet e brendshme.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative, janë:

- Zhvillon politika, procedura, projekte dhe strategji për funksionimin sa më cilësor të TI-së të Ministrisë;
- Zhvillon dhe zbaton politika dhe procedura teknologjike në përputhje me ato të organizatës, për të siguruar një operim efikas të departamenteve të veçanta;
- Zbaton politika dhe udhëzime që dalin nga Ministria, në pajtim me kornizën ligjore;
- Bashkëpunon me departamentet në hartimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e politikave, objektivave, planifikimeve afatshkurta dhe afatgjata në fushën e TI-së;
- Bën zhvillimin, administrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të rrjetit, sistemit dhe aplikacioneve të Ministrisë;

¹⁶ Raporti i Auditimit: "Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike"

- Bashkëpunon dhe mban takime të rregullta me njësitë organizative të Ministrisë për adresimin e kërkesave për avancim, zhvillim, administrim, përmirësim, ndryshim, trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të rastësishme (ad-hoc), që mund të dalin në lidhje me sistemet e TI-së;


Në kuadër të Departamentit bëjnë pjesë divizionet, si vijon:

- Divizioni për Infrastrukturë dhe Sigurinë e TI-së;
- Divizioni për Operacione të TI-së; dhe
- Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes këtij projekti ka synuar të unifikoj sistemet softuerike të Doganës së Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe të institucioneve tjera nëpërmjet një deponie të të dhënave dhe të implementoj një makinë për analizë biznesi apo inteligjencë biznesi (Business Intelligence) në mënyrë që të posedoj informacione në kohë reale për statusin dhe zbatimin e politikave qeveritare në njërin anë, avancimin e politikave qeveritare dhe rritjen e transparencës në anën tjetër.

Burimi i të Dhënave

Grafiku 2. Deponia e të Dhënave me akteret aktuale të popullimit të sistemit.



Sipas përshkrimit të sistemit më lart, Agjencitë dhe departamentet përgjegjëse të Ministrisë, bëjnë deponimin e të dhënave të tyre brenda sistemit të Teknologjisë Informative në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe krijimin e një sistemi raportues analitik.

Tabela 2. Sistemet aktuale që shfrytëzohen nga MFPT-së dhe agjencitë e saj.

Id	Organizata	Emri dhe Verzioni i Sistemit	Teknologjia
1	Ministria e Financave/Thesari	Freebalance	Oracle
2	MF/Departamenti i Buxhetit	Sistemi për Menaxhimin e Buxhetit	Oracle
3	MF/Departamenti i Buxhetit	PIP- Sistemi i menaxhimit të investimeve kapitale	MySQL, PHP app
4	MF-ATK	Sigtas	Oracle
5	MF- Departamenti i Tatimit në Pronë	Sistemi i Tatimit në pronë	PostgreSQL - Java app
6	MF Doganat e Kosovës	Asycuda	Oracle
7	MAP	Sistemi i Pagave	MS SQL- Visual Studio .Net

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative, në kuadër të të cilit funksionojnë këto divizione: Divizioni për Infrastrukturë dhe Sigurinë e TI-së, Divizioni për Operacione të TI-së dhe Divizioni për Menaxhim të Aplikacioneve. Pjesë e fushëveprimit do të jetë Divizioni për Modelim Makroekonomik, KKRF, Divizioni Për Ekzekutim të Buxhetit dhe Raportim.

Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2025, me qëllim analizimin e implementimit dhe efektit të projektit “Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Deponisë së të Dhënave dhe Implementimi i Inteligjencës biznesit”. Ndërsa, për të vlerësuar arsyeshmërinë e inicimit të një projekti të tillë dhe zbatimit, do të analizohet edhe periudha nga viti 2017.

Pyetjet audituese

Për t’iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjet si në vijim:

1. Si i identifikon, priorizon dhe menaxhon MFPT kërkesat për sistemet e TI-së?
2. A vlerëson dhe monitoron në mënyrë efektive menaxhmenti i MFPT-së përdorimin e sistemit të TI-së në organizatë, me qëllim të përmbushjes së misionit të organizatës?
3. Si e menaxhon dhe kontrollon zhvillimin ose blerjen e projekteve të aprovuara për TI-së MFPT?
4. A sigurojnë kontrollet e aplikacionit integritetin dhe plotësinë e transaksioneve të tij?

Kriteret e auditimit¹⁷

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së¹⁸, Manuali i punës për Certifikimet e Auditimit në Sistemet e Informacionit të Shoqatës për Kontrollën dhe Auditimin e Sistemeve të Informacionit¹⁹, Kontrata për Integrimi i sistemeve, Krijimi i Deponisë së Dhënave dhe Implementimi i Inteligjencës së Biznesit.²⁰

Për të vlerësuar menaxhimin e projekteve të MFPT-së dhe funksionimin e sistemeve nga identifikimi i nevojave, planifikimi e deri te zbatimi i projekteve dhe monitorimi i projektit janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- Organizata duhet të analizoj, prioritzoj dhe menaxhoj kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.
- Organizatat duhet të menaxhojnë projektet dhe investimet e tyre të TI-së, me qëllim maksimizimi të përfitimeve dhe konsiderimin e elementëve, të tillë si rrezikun, kapacitetet, dhe prioritzimin në mes investimeve konkurruese.
- Organizata duhet të kryej testimet mbi sistemet e TI-së dhe duhet të bazohet mbi rezultatet për pranimin ose refuzimin e sistemit.
- Aplikacioni identifikon në mënyrë korrekte gabimet në transaksione. Integriteti i të dhënave ruhet edhe gjatë ndërprerjeve të rastësishme në përpunimin e transaksioneve. Ekziston një mekanizëm i përshtatshëm për trajtimin e gabimeve në përpunim, rishikim dhe qartësim të dosjeve në pezullim.²¹

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit, ekipi i auditimit do të kryejë disa aktivitete në institucionet përgjegjëse duke përdorur një sërë teknikash audituese:

- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullative të MFPT-së për sistemet e TI-së;
- Vlerësimin e arsyeshmërisë së kërkesës për iniciimin e këtij aktiviteti;
- Analizimin e kontratës për projektin "Integrimi i sistemeve, krijimi i deponisë së dhënave dhe implementimi i inteligjencës së biznesit", me numër protokoli 1058;
- Analizimin e planit të menaxhimit të kontratës;

¹⁷ Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

¹⁸ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAT-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAT-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

¹⁹ ISACA - Manuali i Rishikuar Edicioni i 27të, i përditësuar për praktikën e punës 2019, për Certifikimin e Auditorit të Sistemeve të Informacionit.

²⁰ Kontrata Publike Kornizë: "Krijimi i Deponisë së Shënimeve dhe Implementimi i Inteligjencës së Biznesit".

²¹ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAT-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAT-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

- Analizimin e raporteve të monitorimit të kontratës;
- Intervistimin e personave përgjegjës dhe strukturave udhëheqëse të institucioneve;
- Intervistimin e zyrtarëve të agjencive, shfrytëzues të këtij sistemi;
- Analizimin e manualeve për përdorimin e sistemit;
- Vlerësimin faktik të efektit të sistemit në lehtësimin e qasjes në të dhëna.

Dokumentet relevante

Ligjet

- Ligji nr. 03/1-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Rregulloret

Rregullore Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë dhe numrin e autoriteteve të larta të administratës shtetërore, si dhe fushat e përgjegjësisë dhe numrin e organeve të larta të administratës shtetërore.

Dokumente relevante

- Dokumentimi teknik 201-17-46-211,
- Vlerësim dhe plan strategjik Plani për TIK.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

DATË/A:	22.08.2025
REFERENCË:	/ 2024
PËR/ZA/TO:	z. Samir Zymberi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë Informative, Zyra Kombëtare e Auditimit
NGA/OD/FROM:	z. Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër konfirmimi për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Depos (Warehouse) së të Dhënave dhe Implementimi i Inteligjencës Artificiale

I nderuar z. Zymberi,

Përmes kësaj, konfirmojmë se:

- Kemi pranuar draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit Integrimi i Sistemeve, Krijimi i Depos (Warehouse) së të Dhënave dhe Implementimi i Inteligjencës Artificiale (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna pajtohem, dhe nuk kemi ndonjë koment shtesë për përmbajtjen e Raportit;
- Ju njoftojmë se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit përfundimtar, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, i cili do të përfshijë edhe afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Arton Ahmeti,

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës

